

Kultivimi i fidaneve të domates

Kultivimi i fidanëve të perimeve është një proces mjaftë kompleks dhe delikat, i cili kryhet nëpërmjet aplikimit korrekt të praktikave bujqësore; duke filluar nga përgatitja e moduleve për mbjellje, mbjellja e farës nëpër module, monitorimi i mbirjes, kultivimi i rasatit dhe transplantimi i tij në fushën kultivuese.

Instruksonet kryesore për kultivim:

1. Informimi mbi të dhënat e përgjithshme të farës;
2. Mbushja e moduleve me substrat dhe ngjeshja e tyre;
3. Vendosja e farave nëpër module;
4. Mbulimi i farave;
5. Ujitja;
6. Vendosja në inkubator për mbirje.

Domatja është bimë barishtore një vjeçare që i takon familjes Solanaceae. Suksesi i kultivimit të kësaj kulture përcaktohet nga faza e parë e kultivimit të tyre, gjegjësisht nga përgatitja e fidanëve. Hapat kryesor për një sukses të garantuar të kultivimit të domateve janë: **përzgjedhja e farës** cilësore, **substratit** dhe **kujdesi intensiv** në fazat e para të kultivimit.

- Fara e domates duhet të jetë hibride ose e trajtuar me preparate adekuate;
- Substrati duhet të jetë i dezinfektuar dhe i pasur me materie minerale të nevojshme për kultivimin e bimës;
- Modulet të kenë vrima standarde të nevojshme për qëndrimin e bimëve në to deri në kohën e ndërrimit në vendin e caktuar;

Masat e përkujdesjes gjatë përgatitjes së fidanëve:

- Nga mbjellja deri në mbirje nuk ka nevojë për dritë; Arsyeja kryesore është që bima të koncentrohet në zhvillim të sistemit rrënjor dhe kjo arrihet duke mos pasur dritë nga jashtë.
- Temperatura duhet të jetë sa më afër optimale. Gjatë kësaj kohe preferohet që temperatura të jetë rreth 22-25°C.
- Të ketë lagështi të mjaftueshme. Lagështia e substratit duhet të kontrollohet vazhdimisht, ndërsa ujitjet duhet të kryhen sipas nevojës.